

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-  
Ministry of Culture, Youth & Sports

QENDRA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE - PRIZREN

|                        |                                                                                   |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 05.07.2017                                                                        |
| REFERENC-Ë:            | 233                                                                               |
| PËR/ZA/TO:             | Drejtoria për Urbanizëm dhe<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komuna e Prizrenit |
| CC:                    |                                                                                   |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                                                   |
| NGA/OD/FROM:           | Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren                                           |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Njoftim për kyqjen në kanalizim                                                   |


Të nderuar

Nëpërmjet këtij informimi zyrtar, ju njoftojmë që në kuadër të projektit të investimeve kapitale: Masat emergjente, dhe bazuar në Aktvendimin e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (me nr. 04-353/01-33740), Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, ka filluar me implementimin e punimeve në Ndërtesën e Postës së Parë të Qytetit;

Si rezultat i vendosjes së gypit për drenazhim rreth perimetrit të ndërtesës nevojitet që të realizohet kyçja në rrjetin e kanalizimit.

Pas përfundimit të punimeve për kyçje, gropa e hapur do të sanohet dhe do të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Bashkëngjitur e gjeni kopjen e aktvendimit (Nr. 04-353/01-33740)



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-33740

Dt. 19.04.2017

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e ORTK me seli në rrugën "Marin Barleti" nr. / Prizren e në bazë të neneve 3alineja 1 pikat 1.1,1.6,1.7 ,1.11, 1.17.1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2 ,e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.3 dhe 1.4 si dhe nenit 14.alineja 1 pika 1.4 dhe 1.5 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, dhe në harmoni me dipozitat e nenit 3 alineal pikat 1.1,1.3,1.5,1.6,1.6,1.7,dhe 1.8 e lidhur me nenet 4,5, dhe 9 dhe 11të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82. e në lidhje me nenin 84. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

## AKTVENDIM

I. LEJOHET: ORTK në zhvillimin e punimeve në renovimin e kulmeve të objekteve të familjeve Pomaku, Shukriju , Myftiu shtëpia në kompleksin Pantelija ,Kabashi – Hapqiu dhe Alili dhe të objekteve publike : renovimi i kulmit dhe konservimi i fasadës në ndërtesën e postës së parë të qytetit ,renovimi i kulmit në xhaminë e Myderiz Ali Efendiu,pastrimi dhe konservimi i krojeve të vjetra .

II. Gjatë renovimit nuk lejohet kurfar ndryshimi i zgjerimit në gabarit dhe në etazhitet të objektit.

III.Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh.

IV.Ivestitori duhet të përmbahet kushteve të Rekomandimit nr.322 dt. 02.09.2016 nga MKRS edhe Rekomandimi i KTKQH Prizren të dt.05.04.2017

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

VI. Pas kryerjes së punimeve shfrytëzuesi obligohet të pastroj vendpunishten.

## Arsyetim

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se:


Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional të Komunës së Prizrenit.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për renovimin e kulmeve të objekteve të familjeve Pomaku, Shukriju ,Myftiu ,shtëpia në kompleksin Pantelija ,Kabashi – Hapqiu dhe Alili dhe të objekteve publike : renovimi i kulmit dhe konservimi i fasadës në ndërtesën e postës së parë të qytetit ,renovimi i kulmit në xhaminë e Myderiz Ali Efendiu,pastrimi dhe konservimi i krojeve të vjetra .

Nga se u tha më lartë u murr aktvendimi si në dispozitiv.  
**KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.  
Ankesa taksohet me 0,50 € taksa administrative.

Bashkëpunëtor profesional:

Afërdita Mormorina, inxh.dipl.ark.



**DREJTORI**

Visar Islamaj

